



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr. 962/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit “I...” SH.P.K me seli në Prizren, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë dhe propozimit/kërkesës së paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ - vendimit nr.528/2019 të datës 18.10.2019, objekt kontesti Vlerësim tatimor, vlerë kontesti 46,390.80 euro, jashtë seancës, me datë 26.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË padia me shenjën KF nr. 962/2022, dhe propozimi - kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ - vendimit nr.528/2019 të datës 18.10.2019, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, si e parakohshme.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi “I...” SH.P.K me seli në Prizren, me padinë-ankesën e datës 12.10.2022 ka iniciuar në Gjykatë kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të aprovet padia, të ndryshohet akti administrativ Vendimi mbi Njoftim Vlerësimin i ATK-së, për interesa dhe ndëshkime me rastin e nxjerrjes së raportit si dhe interesat dhe ndëshkimet pas raportit, ashtu që të pranohet ankesa e parashtruar kundër Njoftim Rivlerësimit nga Kontrolli për pjesën e interesave dhe ndëshkimeve si dhe interesat dhe ndëshkimet që rrjedhin pas kësaj dhe të anulohen interesat dhe ndëshkimet, si dhe të obligohet Administrata Tatimore e Kosovës – Regjioni i Prizrenit që të bëjë korrigjimin e gjendjes së borxheve në emër të tatimpaguesit “I...” SH.P.K me nui:, ashtu që të shlyhet interesi dhe ndëshkimi për kategoritë e tatimeve duke përfshirë periudhën e lindjes së tyre 01.01.2015 e deri më tani: Interesi në shumë prej 12,781.98 € dhe ndëshkimi në

shumë prej 33,608.77 €, gjithsejtë në vlerë prej 46.390.80 €, me padi ka propozuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të ATK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me aktvendimin KF.nr.962/2022 të datës 12.10.2022, paditësit “IBPK Prizreni” SH.P.K, me seli në Prizren, i’a ka kthyer në plotësim padinë/ankesën dhe kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të datës 12.10.2022, ashtu që të përcaktoj qartë aktin administrativ përfundimtar të kundërshtuar, si dhe të përcaktoj qartë kërkesëpadinë dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit në aspektin subjektiv dhe objektiv, pra kush janë palët ndërgjyqëse dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet veprimi ndaj këtij akti administrativ të kundërshtuar, të bashkëngjitet akti përfundimtar i kontestuar si dhe të përcaktohet vlera e kontestit, nën kërcënim të pasojave ligjore nga 33 i LKA-së.

Paditësi “I...” SH.P.K me seli në Prizren, me datën 25.10.2022 ka paraqitur parashtresën për plotësimin e padisë dhe kërkesës për shtyrjen e aktit administrativ të kontestuar, duke e njoftuar gjykatën se ka kontestuar Njoftim Rivlerësimin e ATK-së të datës 18.10.2019, dhe vendimin 528/2019, të ZGJONA- ATK-ë, tutje ka bashkëngjitur raportin e kontrollit 185/18.10.2019, vendimin e zyrës për gjoba dhe ndëshkime administrative nr. 528/2019 të datës 18.10.2019, si dhe njoftim rivlerësimet, e të cilat nuk janë akte përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative pranë të paditurës ATK-ë.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, ka ardhur në përfundim se paditësi nuk ka respektuar procedurën e ankesës pas pranimit të raportit të kontrollit 185/18.10.2019, Vendimit të zyrës për gjoba dhe ndëshkime administrative nr. 528/2019 të datës 18.10.2019, si dhe njoftim rivlerësimeve, pra i njëjti nuk ka bërë ankesë në Departamentin e Ankesave të ATK-së, por ka ushtruar padi me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit në gjykatë me datën 12.10.2022, të plotësuar me parashtresën e datës 25.10.2022, nga e cila rrjedh se i njëjti nuk i ka shtjerr të gjitha mjetet e rregullta juridike pranë të paditurës. Gjykata nga raporti i kontrollit nr. 185/18.10.2019, dhe vendimi i zyrës për gjoba dhe ndëshkime administrative nr. 528/2019 i datës 18.10.2019, ka gjetur se të njëjtat e kanë këshillën juridike me të drejtë ankese në departamentin e ankesave pranë ATK-së, dhe jo në gjykatë siç ka vepruar këtu paditësi. Prandaj, gjykata në bazë të nenit 34 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet

Administrative padinë e paditësit dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit e ka hedhë poshtë si të parakohshme.

Tutje gjykata ka elaboruar edhe nenin 13, të LKA-së, e i cili në paragrafin 1, përcakton shprehimisht se *“1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”*, si dhe paragrafin 2, të këtij neni ku theksohet se: *“ Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”*. Ndërsa me nenin 14, të LKA-së, përcaktohet se *“Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”*.

Po ashtu, me nenin 34, par 2 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar shprehimisht se *“për shkaqe të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, gjykata mund të hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës”*, tutje sipas nenit 34 par. 1, pika 1.1 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative është përcaktuar se *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: padia është e parakohshme”*.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Për këto arsye, e në kuptim të dispozitave ligjore të 34 par 2, lidhur me par.1 pika 1.1 të këtij neni të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.962/22, datë 26.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar GASHI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.